



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 03 qershor 2019
Nr. ref.: RK 1367/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI22/19

Parashtrues

Sabit Ilazi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 377/2018, të 20 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sabit Ilazi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 377/2018, të 20 nëntorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi.
7. Më 20 shkurt 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 8 maj 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës, sipas Kontratës së punës për kohë të caktuar (nr. 11738/o), ka qenë i punësuar pranë Korporatës Energjetike të Kosovës në Prishtinë (KEK), dhe atë në periudhën prej 1 tetorit 2009 deri më 31 dhjetor 2009.
10. Më 16 nëntor 2009, KEK-u, përmes Njoftimit (nr. 235) e njoftoi parashtruesin e kërkesës se atij i shkëputet kontrata e punës (nr. 11738/o) në bazë të rekomandimit të Komisionit Disiplinor, e për shkak të parregullsive në punë dhe rezultateve të dobëta të punës.
11. Më 19 nëntor 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj këtij Njoftimi në KEK.
12. Më 25 nëntor 2009, KEK-u përmes Vendimit (nr. 284) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin për shkëputjen e Kontratës së punës.

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me propozim që ajo ta anulojë Njoftimin e KEK-ut për shkëputjen e Kontratës së punës dhe ta aprovojë padinë e tij për kthim në vendin e punës.
14. Më 31 janar 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [C. nr. 2751/09] aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, anuloi Njoftimin e KEK-ut me të cilin është shkëputur kontrata e punës dhe e detyroi KEK-un ta kthejë parashtruesin në vendin e punës të parashikuar me Kontratë.
15. Në një datë të pacaktuar, KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, për shkak të *“shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës të shkallës së dytë që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar”*.
16. Më 1 korrik 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 5300/2012] aprovoi ankesën e KEK-ut, prishi Aktgjykimin [C. nr. 2751/09] e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe e ktheu çështjen në të njëjtën gjykatë në rivendosje. Në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, thuhet: *„...në rastin konkret nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike në këtë çështje juridike nga se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë vlerësim të drejtë lidhur me kontratën e punës e lidhur në mes të paditësit si punëmarrës dhe të paditurës si punëdhënëse dhe mbi këtë gjendje të vërtetuar gabimisht është zbatuar e drejta materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për anulimin e aktvendimeve të të paditurës si të kundërligjshme dhe kthimin e tij në punë”*.
17. Më 30 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, në procedurën e përsëritur, nxori Aktgjykimin C. nr. 1827/13, me të cilin e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, anuloi Njoftimin e KEK-ut, me të cilin është shkëputur Kontrata e punës dhe e detyroi KEK-un që parashtruesin ta kthejë në vendin e punës të parashikuar me Kontratë.
18. Në një datë të pacaktuar, KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të *„shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit”*.
19. Më 2 shtator 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 4409/2014] aprovoi ankesën e KEK-ut, anuloi Aktgjykimin [C. nr. 1827/13] e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe e ktheu çështjen në të njëjtën gjykatë në rivendosje. Në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, thuhet: *„...pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas vërejtjeve nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë Ac. nr. 5300/12 i dt. 31.01.2011, në të cilin aktvendim jepen udhëzime shumë të qarta për gjykatën e shkallës së parë, e kur dihet se sipas dispozitës së cekur më lartë udhëzimet e gjykatës së shkallës së dytë janë të detyrueshme për gjykatën e shkallës së parë*.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri procedurë të evitoi të metat e sipërpërmendura, ashtu që duke i zhvilluar të gjitha provat e nevojshme, duke e vlerësuar kontratën e punës të cekur më lartë, si dhe duke ju përmbajtur udhëzimeve nga vendimi i gjykatës së shkallës së dytë i cekur më lartë dhe duke i marrë parasysh edhe pretendimet ankimore, kështu që pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, të fakteve dhe rrethanave të sipërpërmendura të merr vendim të drejtë, meritë dhe të bazuar në ligj”.

20. Më 29 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, në procedurën e tretë të përsëritur, nxori Aktgjykimin C. nr. 2162/13, me të cilin aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, anuloi Njoftimin e KEK-ut me të cilin është shkëputur kontrata e punës dhe e detyroi KEK-un ta kthejë parashtruesin në vendin e punës të parashikuar me Kontratë.
21. Në një datë të pacaktuar, KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të „shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit”.
22. Më 29 shkurt 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac. nr. 1657/2014] aprovoi ankesën e KEK-ut dhe duke dhënë arsyetim të detajuar lidhur me gjendjen faktike dhe aplikimin e ligjit e ndryshoi Aktgjykimin [C. nr. 2162/13] e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës.
23. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të „shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që revizioni të aprovohet dhe të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë gjersa të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë”.
24. Më 20 nëntor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjyimit [Rev. nr. 377/18] refuzoi kërkesën e parashtruesit për revizion, me arsyetim se gjykata e shkallës së dytë e kishte vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, kishte zbatuar drejtë të drejtën materiale dhe procedurale dhe se aktgjykimi i kontestuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të procedurës kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta e kanë shkelur të drejtën e tij të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës, pasi që ndërprerja e Kontratës së punës në rastin e tij ishte e paligjshme.
26. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se në procedurën para gjykatave të rregullta gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë, përkatësisht, parashtruesi konkretisht pretendon se “gjendja e fakteve nuk ishte ajo që u prezantua nga e paditura dhe pa të drejtë u akceptu nga gjykata”.

27. Parashtruesi gjithashtu pretendon se *“faktet ishin deponuar në gjykatë por gjykata padrejtësisht refuzoi kërkesëpadinë duke mos siguruar gjykim të drejtë dhe të paanshëm por duke i falë besimin vetëm pretendimeve në fjalë të paditurës”*.
28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata ta aprovojë kërkesën si të pranueshme, si dhe ta shpallë të pavlefshëm dhe ta kthejë në rivendosje Aktgjykimin [Rev. nr. 377/18] e Gjykatës Supreme, të 20 nëntorit 2018.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara më tej në Ligj. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

32. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe ka dorëzuar kërkesën me kohë.
33. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 39 (2) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parashikon:
- „(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij“.*
34. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
35. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata vëren se ndërprerja e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me shkeljen e detyrave dhe përgjegjësisë në punë, të parashikuara me Ligjin e Punës dhe aktin nënligjor të KEK-ut.
36. Gjykata, për më tepër, vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e kësaj të drejte kushtetuese kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë administruar provat para tyre, se si kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe se si kanë interpretuar dhe aplikuar të drejtën materiale dhe procedurale në rastin e parashtruesit të kërkesës. Andaj, për këto pretendime, si të tilla, Gjykata vlerëson se ngrenë çështje të ligjshmërisë me të cilat merren gjykatat e rregullta në përputhje me kompetencat që ua jep atyre Kushtetuta.
37. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit në arsyetimin e saj, shpjegoi se: *„...në shkresat e lëndës ekziston kontrata e punës nr. 11738/0 e datës 01.10.2009, kontrata e punës në kohë të caktuar, vërejtja e fundit me shkrim e cila i është shqiptuar paditësit për rezultatet e dobëta të punës – performancës, ashtu që, me vërejtjen e fundit me shkrim paditësi ka qenë i paralajmëruar nga e paditura që mos përmbushja e performancës apo shkeljeve tjera të detyrave të punës, do të sjell deri te shkëputja e kontratës së punës edhe para afatit të skadimit të saj, e që një gjë e tillë është paraparë edhe në dispozitën e nenit 11 të Kontratës së punës“.*
38. Më tej, Gjykata e Apelit në vazhdim arsyetoi se: *„...në dispozitën e nenit 69 3.1 të Ligjit të Punës është paraparë: „Të punësuarit mund t'i ndërprehet Kontrata e Punës pa njoftim paraprak në formë të shkruar të përcaktuar në par. 1 të kësaj dispozite ligjore në rast kur i punësuari është fajtor për mos përmbushjen e detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontrata e Punës“, ndërsa e paditura të njëjtin e ka njoftuar me vërejtjen e fundit me shkrim për shkak të mos përmbushjes të performancës. Kurse në dispozitën e nenit 70 par. 1. 1.4.1, 1.4.2 dhe 1.6.2 të Ligjit të Punës është paraparë „se punëdhënësi mund t'ia ndërpres Kontratën e Punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit, për shkak të përmbushjes të pakënaqshme të detyrave të punës si dhe kur performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim“, e nga shkaqet e cekura më lartë, aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar“.*

39. Në fund, Gjykata Supreme në arsyetimin e saj shpjegon se: „në bazë të nenit 11.5 të Rregullores 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës i cili ka hy në fuqi më 8 tetor 2001, saktësisht është përcaktuar se kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi. Punëdhënësi do të njoftoj punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës ashtu që në njoftim theksohen edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës dhe punëdhënësi do ta mbajë një takim me punonjësin me të cilin rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punëmarrësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Po ashtu në bazë të nenit 8.4 të Rregullores për operacionet e distrikteve të paditurës saktësisht parashihet se në rast të shkeljeve të detyrave të punës të cilat përfaqësojnë bazë për shkëputjen e kontratës së punës. E paditura në rastin konkret i ka respektuar dispozitat të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë pikërisht nenin 11.5 nën pikën (a) dhe (b) e lidhur me nenin 8 të Rregullores për operacionet e distrikteve të paditurës me rastin e shkëputjes e kontratës së punës të punëmarrësit.
Gjykata Supreme konsideron se njoftimi përkatësisht vendimi i të paditurës anulimi i të cilit kërkohet nuk është i kundërligjshëm për arsye se është marrë në bazë të dispozitave të ligjeve të cekura më lart”.
40. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës në këtë lëndë ankohet kryesisht për vlerësimin e provave dhe rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Gjykata rikujton se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e „shkallës së katërt“ duke vënë në dyshim rezultatin e procedurës së rregullt. Gjykatat e rregullta janë në pozitën më të mirë për të vlerësuar relevancën e provave në lëndë dhe për të interpretuar dhe zbatuar rregullat e së drejtës materiale dhe procedurale (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, *Vidal kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 22 prillit 1992, Seria A nr. 235-B, f. 32-33, paragrafi 32).
41. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit apo të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28, shih, po ashtu, Aktgjykimin *Donadze kundër Gjeorgjisë*, të 7 marsit 2006, nr. 74644/01, paragrafët 30 dhe 31).
42. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës në procedurën e rregullt ka pasur përfitime nga procedura kontradiktore. Parashtuesi i kërkesës ishte përfaqësuar juridikisht gjatë gjithë procedurës dhe kishte mundësi për të dëshmuar të drejtën e tij në lidhje me kontratën e punës për kohë të caktuar dhe për të paraqitur dëshmi që shkojnë në favorin e tij në lëndë. Gjykata e Apelit e arsyetoi në hollësi aktgjykimin në meritat e çështjes dhe i dëgjoi të dyja palët. Për më tepër, arsyet faktike dhe juridike për refuzimin e lëndës janë paraqitur në detaje në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Në këto rrethana, nuk mund të pretendohet se gjykatat e rregullta i kanë anashkaluar aspektet e rëndësishme të rastit apo se nuk e kanë marrë parasysh sfondin historik të kontestit (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 54).

43. Duke shikuar procesin si tërësi, Gjykata vlerëson Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, në vendimet e tyre ofruan përshkrim të gjerë dhe të plotë të gjetjeve të tyre, duke dhënë arsye të shumta në përgjigje të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55).
44. Si përfundim, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij se i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta mbështes pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
45. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit, në baza kushtetuese, duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 maj 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi